

**EDMOND MALAJ****KASTRIOTËT DHE RAGUZA**

Raguza ka pasur marrëdhënie aktive me shumë fisnikë dhe principata të trojeve shqiptare, si p.sh. me Principatën e Arbrit, Dukagjinët, Matrangajt, Balshajt, Topiajt, Kastriotët etj. Sipas periudhave të caktuara dhe rëndësisë këto marrëdhënie herë kanë qenë të dendura e herë më të rradha duke përfshirë këtu jo vetëm çështje ekonomike, por edhe politike. Në këtë artikull do të bëhet fjalë për marrëdhëniet e Raguzës me Derën e Kastriotëve. Në qendër do të jenë marrëdhëniet e Skënderbeut me këtë republikë, për faktin se ato ishin më të dendura<sup>1</sup> dhe janë të dokumentuara më mirë. Në këtë artikull do të përpiqemi që të japim një vështrim historik të këtyre marrëdhënieve, duke u bazuar kryesisht në burime dokumentare dhe në literaturë shkencore historike, si dhe duke u përqendruar vetëm në disa ngjarje më të rëndësishme të këtyre marrëdhënieve, sepse një paraqitje e plotë e tyre është e pamundur që të jepet brenda një artikulli.

**Marrëdhënie diplomatike dhe politike  
Gjon Kastrioti dhe Raguza**

Marrëdhëniet me Kastriotët janë të dokumentuara qysh në kohën e Gjon Kastriotit, babait të Skënderbeut dhe si dëshmi të parë po paraqesim

---

<sup>1</sup> Konstantin Jireček, "Valona im Mittelalter", në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 179; Ludwig von Thallóczy, Konstantin Jireček, "Zwei Urkunden aus Nordalbanien", në *Illyrisch-Albanische Forschungen...*, f. 138 (ref. 4), f. 142; Irmgard Mahnken, "Beziehungen zwischen Ragusanern und Albanern während des Mittelalters. Randbemerkungen zur Problematik der balkanologischen Forschung", në *Beiträge zur Südosteuropa-Forschung*, Anlässlich des I. Internationalen Balkanologenkongresses in Sofia 26.VIII–1.IX.1966, botuar nga Arbeitskreis Südosteuropa-Forschung bei der Deutschen Forschungsgemeinschaft. München: Trofenik 1966, f. 365.

këtu dokumentin, i cili hedh dritë mbi dhënien e qytetarisë raguzane Gjon Kastriotit, të atit të Skënderbeut. Kjo qytetari i jepet atij njëzëri pa kundërshtim votash në Senat, duke i dhënë kështu Gjonit edhe të gjitha të drejtat dhe imunitetet që përmbante marrja e një qytetarie të tillë. Ky dokument i rëndësishëm thotë, se “*më 21 të marsit të (1413) në Senat bëhet propozimi i parë për zotin Gjon Kastriotin për ta bërë atë qytetar dhe fqinj me të gjitha privilegjet dhe imunitetet me të cilat pranohen qytetarët e tjerë që bëhen të tillë për nder*”<sup>2</sup>. Ky propozim pranohet nga i gjithë Senati dhe merr votat pro të të gjithë anëtarëve. Dy muaj më vonë më 19 dhe më 21 maj (1413) i dha atij dhe trashëgimtarëve të tij qytetarinë edhe Republika e Venedikut, me kërkesën e vetë Gjonit.<sup>3</sup>

Përveç marrëdhënieve diplomatike dhe atyre tregtare që do i cekim shkurt në vazhdim ka nëpër dokumente edhe raste të veçanta, siç ishte për shembull dërgimi i një mjeku pranë Gjon Kastriotit; në lidhje me këtë një dokument i datës 25 maj 1426 na njofton dërgimin me barkë nga Ankona deri në Lezhë të një mjeku të njohur me emrin Tomas (*Magister Thomas*), pasi ishte pyetur, nëse kishte dëshirë (*si contentus est ira ad Castriotum*)<sup>4</sup> të qëndronte tek Gjon Kastrioti për afërsisht dy muaj.<sup>5</sup>

Në vitin 1430, sulltan Murati pushton Selanikun dhe pas kësaj ngjarjeje djemtë e Gjon Kastriotit duhej të merrnin pjesë nëpër ekspeditat ushtarake, sa herë që u kërkohej. Megjithatë, besohet se ata mund të ktheheshin në Arbëri sa herë që të donin, ku mund të kalonin edhe lejen.<sup>6</sup> Janë pikërisht dokumentet raguzane që tregojnë qartë, se pas rënies së Selanikut u mund edhe Gjon Kastrioti. Pra, kjo çon në hamendësimin që

<sup>2</sup> *Državni Arhiv u Dubrovniku* (më tej: DAD), Reform. XXXVI/188, në *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV*, vëll. III (1411-1416), transkriptuan dhe përkthyen: Injac Zamputi, Përparime Huta, redaktoi dhe përgatiti për botim: Edmond Malaj, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2018, dok. nr. 223.

<sup>3</sup> *Archivio di Stato di Venezia* (më tej: ASV), Grazie XX (XVIII)/ 62 (79), në *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shekullit XV...*, vëll. III (1411-1416), dok. nr. 242.

<sup>4</sup> L. von Thallóczy, K. Jireček, “Zwei Urkunden ...”, f. 139.

<sup>5</sup> *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në fondet e Arkivit Shtetëror të Dubrovnikut*, Dokumente, Hulumtoi dhe përgatiti Gjon Berisha, Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë, Prishtinë: 2018, nr. IX.

<sup>6</sup> Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405-1468)*, Tiranë: Naim Frashëri, 1967, f. 77.

Gjoni u detyrua në vitin 1430 që të dorëzonte bijtë e tij si pengje tek sulltani dhe në atë kohë Skënderbeu ishte 26 vjeç.<sup>7</sup> Gjatë kësaj kohe pra, që nga viti 1430 e deri në vitin 1436 Gjoni me të bijtë kishin pranuar fenë islame dhe i ishin nënshtruar sulltanit, siç shkruan edhe papë Piu II,<sup>8</sup> dhe marrëdhëniet me Raguzën e me vendet e tjera të krishtera, si me Venedikun e me Hungarinë ata fillojnë t'i zhvillojnë sërish pas vitit 1436.<sup>9</sup> Në vitin 1438 ishte bërë katolik dhe kishte lidhur sërish aleancë qoftë me Raguzën qoftë me Venedikun. Sipas F. Nolit, i cili i referohet edhe Piut II, Gjon Kastrioti vdes në vitin 1443 si i krishterë.<sup>10</sup>

Në lidhje me vdekjen e tij autorë të tjerë na japin një tjetër datë, 2 maj 1437.<sup>11</sup> Gjoni e varrosën në *Katolikonin e Manastirit të Hilandarit*<sup>12</sup>, ku ai më përpara kishte blerë edhe një pirg (kullë), e cila më vonë u njoh me emrin Pirgu i Kastriotëve apo *Pirgu Arbëror* në manastirin Hilandar të Atosit. Sipas autorit serb Boško Bojović<sup>13</sup>, por edhe nga të dhëna që mund të nxirren nga një faqe interneti e vetë Manastirit, vitet e fundit të

<sup>7</sup> *Po aty.*

<sup>8</sup> “*In haec terra potes Camusa fuit, qui Christianis parentibus ortus, parum tenax catholicæ fidei, ad Muhametis infaniam declinauit.*” Pii. II. Pon. Max. *Asiae Europaeque elegantissima descriptio mira festiuitate tum veteru[m], tum recentium res memoratu dignas complectens, maxime quae sub Frederico III. apud Europeos Christiani cum Turcis, Prutenis, Soldano, & cæteris hostibus fidei, tum etiam inter sese vario bellorum euentu commiserunt.* Accessit Henrici Glareani, Helvetii, poetæ laureati compendiararia Asiae, Africae, Europæque descriptio. Parisiis: Apud Galeotum a prato, ad primam Palatij regij columnam. 1534, f. 337.

<sup>9</sup> F. S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, f. 96.

<sup>10</sup> “*Sed quam leuiter Christum deferuit, tam bacile Muhametis sacra contempsit. Redijt enim ad paternam legem, & quãuis vtranque religionem contempserit, neutri fidus, Christianus tamen mori Turca maluit, paulo post Costantinopolitanam cladem morbo extinctus.*” Pii. II. Pon. Max. *Asiae Europaeque elegantissima descriptio*, f. 338; shih edhe: F. Noli, *Skënderbeu...*, f. 64.

<sup>11</sup> Oliver Jens Schmitt, *Skanderbeg. Der neue Alexander auf dem Balkan*, Regensburg: Pustet, 2009, f. 36.

<sup>12</sup> “*Ivan Kastriot i njegov mlađi sin Repoš su se zamonašili u Hilandaru i nakon upokojenja su sahranjeni u hilendarskom katolikonu.*” “Pirg Svetog Đorđa, Arbanaški pirg” URL: [http://www.hilandar.info/strana\\_sr.php?strana\\_id=104#prettyPhoto\[rel\]/2/](http://www.hilandar.info/strana_sr.php?strana_id=104#prettyPhoto[rel]/2/) (20. 12. 2020)

<sup>13</sup> Boško Bojović, “Mont Athos, les princes roumains, Jean Castriot et la Tour albanaise (Arbanaški pirg) dependance de Chilandar”, në *Balkanica XXXVII/2006*, Balkanološki Institut - Srpska Akademija Nauka i Umetnosti, Belgrade: 2007, f. 81-87.




Fig. 1: Pamja bashkë me një Scicë e Pirgut të Kastriotëve, i njohur si *Arbanksi Pirg*. Burimi: Shih referencën, nr. 12 të këtij artikulli.

jetës së tij Gjoni kishte jetuar atje si murg<sup>14</sup> me të birin Reposhin dhe përveç tij në katolikon, ka varrin edhe Reposhi.<sup>15</sup>

Më vonë, pas vdekjes së Gjon Kastriotit (1437), Senati i Raguzës e konfirmon qytetarinë dhe u jep edhe djemve të Gjon Kastriotit nënshtetësinë e Republikës, duke përjashtuar këtu Gjergj Kastriotin, i cili asaj kohe duhet të ketë qenë në shërbim të Perandorisë Osmane. Vendimi në lidhje me këtë u mor më 10 korrik 1439.<sup>16</sup>

### Skënderbeu dhe Ragusa

Në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet Skënderbeut dhe Raguzës, sigurisht dokumentacioni është më i gjerë dhe me anë të tij mund të ndërtojmë një pasqyrë të përgjithshme të tyre. Këtu po e fillojmë me një dokument të datës 27 maj 1447, i cili bën fjalë për një ndihmë në materiale ushtarake që i jepet Skënderbeut. Kjo ndihmë konsistonte në 500 libra barut bombardash që i dërgohen atij me aprovimin e pothuajse të gjithë Këshillit të Rogatëve.<sup>17</sup>

<sup>14</sup> Po aty, f. 85.

<sup>15</sup> “Pirg Svetog Đorda, Arbanaški pirg” URL: [http://www.hilandar.info/strana\\_sr.php?strana\\_id=104#prettyPhoto\[rel\]/2/](http://www.hilandar.info/strana_sr.php?strana_id=104#prettyPhoto[rel]/2/) (20. 12. 2020)

<sup>16</sup> DAD, Acta Cons. Rog., vol. VII (1438-1441): “*filijs Castrioth. Prima pars est de confirmando filiis Iuani Castrioth (f. I. C. über die Zeile) cartam ciuilitatis (durchstrichen: Georgio Castrioth), prout et quemadmodum facto fuit Iuano Castrioth, patri sou. Per omnes.*” L. v Thallóczy, K. Jireček, “Zwei Urkunden ...”, f. 142.

<sup>17</sup> DAD, Cons. Rog. X, fol. 102, në Jovan Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg i Abanija u XV Beku*. (Istoriska Grača). Srpska Kraljevska Akademia (=Spomenik XCV, Drugi razred, Nr. 74), Beograd: 1942, dok. nr. 14.

Mbi një vit më vonë kemi një kërkesë të Skënderbeut për një hua dhe më 20.10.1448, Raguzia i përgjigjet negativisht Skënderbeut në lidhje me këtë hua që ai ia kishte kërkuar nëpërmjet ambasadorit të tij, ipeshkvit Andrea, ngaqë i duheshin për të shkuar në luftë kundër turkut.<sup>18</sup> Shuma e kërkuar me sa duket ishte 200 dukatë ari dhe Këshilli e hodhi në votë kërkesën një herë për shumën 200 dukatë, pastaj për shumën 100 dukatë dhe si përfundim u shqyrtua mundësia që t'i jepnin atij një dhuratë në pëlhurë.<sup>19</sup> Mbase këtu bëhet fjalë për ndihmën që donte t'i jepte Skënderbeu Janosh Huniadit, i cili u thye nga turqit në Kosovë dhe për këtë nuk dinin gjë raguzanët. Huanë ai e kërkon nëpërmjet Andreas, ipeshkvit të Arbrit. Megjithatë, raguzanët kësaj here i dhurojnë Skënderbeut 200 dukatë.<sup>20</sup> Po në këtë vit, më 14.11.1448, Raguzia vendos t'i dërgojë Skënderbeut dy kuaj “të racës asturia”, si dhuratë.<sup>21</sup> Krahas kësaj, Republika e lajmëronte Skënderbeun, kur turqit planifikonin që ta sulmonin atë, siç është edhe letërkëmbimi midis Skënderbeut dhe Raguzës gjatë kësaj periudhe, nga i cili kemi edhe një letër të

---

<sup>18</sup> DAD, Cons. Rog. XI, fol. 14, në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 24; shih edhe: Dhimitër Shuteriqi, *Moti i Madh*, Përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479, Tiranë: Dituria, 2006, f. 150.

<sup>19</sup> DAD, Cons. Rog. XI, fol. 14. “*Die XX Octobris 1448. Prima pars est de excusando nos a petitione imprestiti denariorum, quam fecit nobis et dominio nostro Scanderbech, dominus Albanensis, per reuerentem in Xpo patrem D. Andream, episcopum et ambaxiatorem suum, pro eundo contra Teucros una cum exercitu Xpianorum, prout arreatum fuit in presenti Consilio. Captum per 36: 2. Prirna pars est de donando Scanderbech predicto. Captum per 34: 4. Prima pars est de donando dicto Scanderbech ducatos auri ducentos. Captum per 21: 17. (Secunda pars est de donando ducatos auri centum).*” *Prima pars est de donando eidem dictos ducatos auri ducentos in denariis ducatorum. Captum per 34: 4. (Secunda pars est de donando eos in pannis).*”, në: J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 24.

<sup>20</sup> Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh ...*, f. 150.

<sup>21</sup> DAD, Cons. Rog. XI, fol. 21: “*Die XIII nouembris 1448. Prima pars est de mittendo donatum ambos astures nobis donatos per dominum Schanderbecho. Captum per 23: 11. Prima pars est de mittendo illos donatum domino cardinali Sancte Marie Nove. Captum per 24: 10. (Secunda pars est de mittendo illos donatum futuro consuli nostro in Syracusio). Prima pars est de declarando et capiendo in presenti Consilio cui donari debeant ipsi astures et postea eundo ad Maius Consilium pro leuanda libertatem super inde. Captum per 19: 15.*” J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 25; shih edhe: Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh*, f. 151.

Skënderbeut në sllavishte të vjetër, të cilën ai e dërgon në Raguzë nga Lezha në qershor të vitit 1450, me anë të së cilës Skënderbeu i bën të ditur Raguzës se lajmëtari dhe prurësi i letrës është vërtet i dërguar nga ai.<sup>22</sup>

Pas betejës së Oranikut më 1448 dhe pas pushtimit të Sfetigradit në vitin 1449, turqit sulmojnë sërish trojet arbërore në vitin 1450 dhe rrethuan Krujën. Kësaj radhe kërcënimi ishte më i madh. Sipas Piskos, më 5 prill 1450 u shfaq pararoja e ushtrisë turke nën komandën e Sevalisë (ose Sebalias), pashait të Krujës dhe afërisht dy javë më pas edhe Murati II me pjesën e madhe të ushtrisë.<sup>23</sup> Biemmi e vendos ardhjen e pararojës turke në mesin e majit.<sup>24</sup> Numri i saj jepet nga Barleti në 160.000 veta.<sup>25</sup> Edhe pse dihet që Barleti e ekzagjeron me numrat, mendojmë se numri real i ushtrisë osmane duhet të ketë qenë vërtetë i lartë, sepse këtu bëhej fjalë për një ushtri që shoqërohej nga vetë sulltani. Këtu duhet të kihet parasysh edhe karrocet dhe mjetet e shumta të transportit që nevojiteshin për furnizimin e saj.<sup>26</sup> Ushtria e Skënderbeut nuk i kalonte të 8 mijë vetat, prej tyre 6000 kalorës.<sup>27</sup>

Mbi këtë rrethim janë të mirinformuar edhe raguzanët. Ja se ç'thuhet në lidhje me këtë rrethim në një dokument raguzan të 13 gushtit 1450, ku jepen edhe detaje mbi armët e turqve, ushtrinë e tyre, por edhe mbi mbrojtësit e qytetit:

“Perandori turk me të birin e vet ka ngritur një ushtri të madhe kundër krahinave të Arbërisë dhe ka bërë llogore rreth Krujës, qytetit të Skënderbegut. Ai përpiket me forca të mëdha e me luftë shumë të egër ta fusi në dorë e ta shtypë këtë qytet. Prandaj ai, mbasi vendosi forcat rreth qytetit, urdhëroi që të nxjerrë nga metali që kishte sjellë me vehte,

<sup>22</sup> Nji Letër e Skanderbegut Republikës së Raguzës, në: *At Gjon Shllaku OFM, Shqyptari – Frati – Shqypnija*, përgatitën për botim: *At Vitor Demaj, OFM, Prof. dr. Aljula Jubani; At Mirash Marinaj, OFM. Shkodër: Botime Françeskane, 2018, f. 100-101.*

<sup>23</sup> Julius Ernest Pisko, *Skanderbeg, Historische Studie*, Wien: Frick 1894, f. 55.

<sup>24</sup> *Istoria di Giorgio Castrियो detto Scander-Begh*, Di Giammaria Biemmi, Prete Bresciano. Seconda Edizione, Brescia: Giammaria Rizzardi, 1756, f. 233.

<sup>25</sup> Marin Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut*, Shqipëruar prej origjinalit latinisht dhe hyrja nga Stefan I. Prifti, Tiranë: Infobotues, 2005, f. 246.

<sup>26</sup> J. Pisko, *Skanderbeg, Historische Studie...*, f. 55.

<sup>27</sup> M. Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut ...*, f. 216-217; shih edhe: J. Pisko, *Skanderbeg, Historische Studie ...*, f. 55.

2 bombardë, më e madhja e të cilave, simbas njoftimeve që na kanë ardhur, hedh një gurë me peshë prej 400 librash. Por edhe qyteti është i përforcuar me të gjitha ato gjëra që nevojiten për mbrojtjen e ruajtjen e tij. Edhe vetë vendi për shkak të ashpërsisë dhe vështirësisë së vet, është e vështirë që të merret. Aty mbrenda gjenden 1500 burra shumë të aftë për mbrojtje. Si rrjedhojë ndër ta ka burra që ushqejnë shpresën, se ushtria turke përpiket kot që të shkatërrojë atë qytet. Vetë Skënderbegu nuk është larg nga llogoret turke. Ai ditë për ditë u shkakton dëme shumë të mëdha armikut, mbasi përfiton nga natyra e vendit e nga malet ku fshihet.”<sup>28</sup>

Dokumenti është një letër që ishte nisur nga Raguzë, për të informuar Janosh Huniadin në lidhje me fushatën ushtarake turke në Arbëri, kundër Skënderbeut dhe i lutet atij që të kujtohet për qytetin e tyre gjatë paqes me turqit. Skënderbeu bën një udhëtim në Raguzë në vitin 1450,<sup>29</sup> pikërisht për këtë problem. Aty dokumentohet si i pranishëm në dhjetor të vitit 1450. Ai u prit aty me respekt të madh dhe ky respekt vihet re edhe për shpenzimet që pati bashkia e qytetit për të. Nëpër dokumente ka të tillë që flasin edhe për shumën që duhej shpenzuar për ushqimin e tij.

<sup>28</sup> DAD, Lett. et Comm. di Lev. 1448-88. fol. 38: “*Teucrorum imperator cum eius filio in partibus Albanie validissimos tenet exercitus, et contra Croiam civitatem Scanderbechi castramentatus est; quam totis viribus et acerrimo belle oppugnare atque opprimere conatur. Conflari enim iussit, postquam castra posuit contra dictam civitatem, ex metallo, quod secum deferri fecerat, bombardas duas, quarum maior, sicuti veris relatibus habuimus, proicit lapidem ponderis librarum quadringentarum. Civitas autem ipsa munitissima est omnium earum rerum, que ad eiusdem defensionem et conservacionem uecessarie sunt, nec locus ille, ad quem propter moncium asperitate difficilis aditus est, satis commode debellari potest. In eo preterea assunt viri 1500 ad defensionem aptissimi. Ex quo creditur, dummodo inter se sunt viri, qui fidem servant, exercitus predictos contra civitatem illam frustra moliri. Schanderbechus quoque non longe est a Teucrorum castris; eis que in dies maxima damna infert, cum babeat locorum et moncium opportunitatem, in quibus se tuto recipere potest.*”, në: József Gelcich, Lajos Thallóczy, *Raguzë és Magyarország összeköttetéseknek oklevéltára*. Budapest: Kiadja A. M. Tud. Akadémia Tört. Bizottsága 1887, dok. nr. 284, f. 474.

<sup>29</sup> Bariša Krekić, “Contribution of Foreigners to Dubrovnik’s Economic Growth in the Late Middle Ages”, në Bariša Krekić, *Dubrovnik, Italy and the Balkans in the Late Middle Ages*, London: Variorum Reprints, 1980, f. 388.

Kjo shumë shkonte mbi 10 hiperperë në ditë<sup>30</sup>, pra një shumë e konsiderueshme për kohën.

Në Raguzë ai kërkoi ndihma me qëllim që të mbronte qytetin e vet Krujën nga turqit.<sup>31</sup> Ndihmat që iu dhanë janë të shënuara nëpër dokumente një vit më vonë, më 1451 dhe u morën nga shumat që ishin mbledhur nga klerikët si lëmosha për papën. Një klerik i tillë, i cili ishte ngarkuar nga papa për mbledhjen e lëmoshave në krahinat përreth qytetit, ishte p. sh. frati Joan Jerolomitano, frat i Kuvendit të Shenjtë. Një dokument i datës 14 dhjetor 1450, flet për një vendimmarrje nga Këshilli i Rogatëve që t'i jepeshin Skënderbeut 500 dukatë.<sup>32</sup> Këtu nuk është e qartë nëse kjo shumë ishte ajo që duhej të nxirrej nga lëmoshat apo ndonjë shumë tjetër.

Skënderbeu me ndihmën që konsistonte në lëmoshat e mbledhura për papën u kthye në Shqipëri dhe *“arriti jo vetëm të mbajë qytetin por futi në dorë një pjesë të mirë të zotërimit të vet”*<sup>33</sup>. Si rrjedhim, për shkak të këtyre ndihmave të dhëna Skënderbeut, Raguzë i kërkonte ndihmë Papës, sepse Regjimenti i Shenjtë që ndodhej në Raguzë dhe që shërbente për mbrojtjen e fesë kishte shpenzime. Republika i kërkonte papës që “një e katërta e mbledhur” nga lëmoshat t'i kalonte në dispozicion këtij

<sup>30</sup> DAD. Cons. Rog. XI, fol. 271: *“Die Jovis decimo Decembris 1450. Prima pars est de induciando ad diem sabati super facto Schanderbechi. Captum per 33:1. Prima pars est de dando libertatem domino Rectori et eius Minori Consilio possendi expendere omni die ab yperperis X infra pro expensis oris fiendis Scanderbegho. Captum per omnes.”*, në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 32.

<sup>31</sup> DAD, Lett. E comm. Di Lev. 1448-1488, fol. 64-68 (Letër e Raguzës dërguar papë Nikollës V më 27. 2. 1451), në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 36; shih edhe: Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh ...*, f. 165.

<sup>32</sup> DAD. Cons. Rog. XI, fol. 272: *“Die XIII decembris . Prima pars est de donando Scanderbech qui ad presens est Ragusii. Captum per 27:5. Prima pars est de eundo ad Maius Consilium pro donando sibi ducatos quingentos. Captum per 18:14. Prima pars est de donando libertatem domino Rectori et eius Minori Consilio dandi responsonem Scanderbech et expediendi eum secundum quod dictis domino Rectori et Consilio videbitur. Captum per omnes.”*, në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 34

<sup>33</sup> DAD, Lett. E comm. Di Lev. 1448-1488, fol. 64-68 (Letër e Raguzës dërguar papë Nikollës V më 27. 2. 1451.) *“[...] li fexe tal subvencione e e subsidio cum denari che, siando ritornato esso Scanderbeg a caixa, provedete a la conservacion della detta cittade, et eciamdio recupero bona parte della sua signoria”*. J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 36; Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh...*, f. 165.



regjimenti.<sup>34</sup> Për këto çështje, Raguzë vendosi të dërgonte në Romë shqiptarin Gjon Gazulli, i cili duhej të pajisej me një bulë nga Raguzë dhe të fliste në Romë gjatë pesë ditëve për punët e Skënderbeut dhe nxjerrjen e lejes me qëllim që të marrë ndihmat Raguzë.<sup>35</sup>

Gjon Gazulli në këtë kohë ishte person i rëndësishëm në Raguzë. Ai ishte vikar i argjipeshkvit të Raguzës dhe rektor i Kishës së Shën Pjetrit të qytetit (*Johanni Gazulo, rectori ecclesie Sancti Petri Maioris Ragusine*)<sup>36</sup>. Disa muaj më vonë, më 13 prill 1451, së bashku me argjipeshkvin e Raguzës, Jakobin, dhe me ipeshkvin e Kotorrit, Bonino de Tolentis, ai ngarkohet nga Papa Nikolla V për t'i dhënë një pjesë të shumës së fituar nga indulgjencat e vitit jubilar 1450, Gjergj Kastriotit Skënderbeut.<sup>37</sup> Por, kjo mbledhje fondesh duket se nuk qe fort e lehtë, sepse në atë kohë kishte edhe një problem tjetër, murtajen, e cila duket se kishte shkaktuar edhe zbrazjen e qytetit. Ja se ç'thotë një dokument në lidhje me këtë:

“Fort të Shenjtnueshmit Atë në Krishtin e fort të lumturit Zotit tonë shumë të shquar, mbas përshëndetjesh shumë të përvujtuna e të puthunash të këmbëve e të shenjtëve. Ndërsa ishim për udhë, që kishim marrë drejt Venedikut, për nevojat e mëdha të komitetit të Kotorrit, më sollën në Raguzë letrën e Shenjtnisë Suaj, të cilën e pritëm dhe e lexuam me nderim të madh. Me anën e kësaj letre Shenjtnia e juaj kishte caktuar Gjon Gazullin, Bonino de Tolentis e mua për të mbledhur paratë nga besnikët e Krishtit, që lypen për të fitue ndjesët e vitit të Jubileut për qytetin e Raguzës, e dominin e tij, për qytete të tjera, tokat vendet, distriktet e çeduarë nënshtetasve me ndërmjetsinë e komunës së qytetit të Raguzës, e për krahina të tjera me ndërmjetësinë e Gjergj Kastriotit, sikurse shihet se janë të urdhnueme nga përmbajtja e letrës së Shenjtnisë së tij. Të gjithë ata njerëz të komunës së qytetit të Raguzës, që e dinë si duhen vënë në zbatim ndjesët e urdhnueme nga Shenjtnia Juej, tregojnë se disa anë të atij qyteti janë nën frikën e rrezikut të murtajes, e se edhe vetë

---

<sup>34</sup> DAD, Lett. E comm. Di Lev. 1448-1488, fol. 64-68 (Letër e Raguzës dërguar papë Nikollës V më 27. 2. 1451), në: J. Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 36; shih edhe: Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh...*, f. 165.

<sup>35</sup> Po aty.

<sup>36</sup> DAD, Acta Sancte Mariae Maioris, F. I. a. 151, fol. 31, në J. Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 40.

<sup>37</sup> Po aty; Dh. Shuteriqi, *Moti i Madh ...*, f. 168.

shteti asht në rrezik për shkak të divergjencave që gjenden ndërmjet Raguzës dhe prijësit Stefan, fqinjët të saj; thonë se të sipërthënë Gjon Gazulli e Bonino de Tolentis janë jashtë qytetit të Raguzës, e njëri prej tyre, Gjoni, asht nisë për tek Skënderbeu dhe tjetri gjendet i sëmurë në Posauri. Të gjithë këto janë shkaqe që pengojnë planin e Shenjtnis Suaj. Prandaj në qoftë se letra e ndjesve shpallet së shpejti, dhe i jepet mundësia që të vijnë në qytet kujtdo nga nënshtetasit, kjo gja nuk mund të bahet pa rrezik të randë për ta, sepse kur qyteti të jetë i mbushun me njerëz, mjafton një shkëndi e asaj sëmundjeje ngjitëse që të ndizet i gjithë qyteti. E nëse ndodhë kjo gja, qyteti në njerën anë nga të vdekunit, në anën tjetër nga të ikunit prej frikës së vdekjes, do të ngelej pa njeri mbrenda. E kjo gja do t'i jepte lehtësinë armiqve të afërm që të zbatonin planet e tyre të poshtra. Për këtë shkak, mbasi mësova arsyet e tyre e mbasi ishte nevoja që unë ta kryeja udhëtimin që kisha nisë, ja mbusha mendjen qytetarëve të sipërthanun ta ndalonin shpalljen e këtyne ndjesëve, e ta lutnin Shenjtninë Tuej, në rast e se do të denjonte të lejonte, për hir te butësisë së tij, që të shtyhet për disa muaj shpallja e tyre; kështu që Shenjtnia e juaj të pranohet të caktojë afatin mbrenda të cilit do të bahet shpallja, mjaft që afati mos të kalojë gjashtë muajshin, nga dita që duhej të bahej shpallja e tyre. Për këtë gja besoj se të gjithë qytetarët e Raguzës do t'i luten Shenjtnisë Suaj. Edhe unë i lutem Shenjtnisë Suaj me nderimet e duhuna, që të denjohet që këtyne qytetarve t'u lejohet të mos ta shpallin letrën e ndjesëve, sepse kjo do të ishte me rrezik e dëm të popullsisë së qytetit.”<sup>38</sup>

<sup>38</sup> DAD, Lettere e comm. di Levante XV, fol. 166: “*Sanctissime in Christo pater et beatissime domine nostri singularissime post humillissima re et pedum oscula beatorum. Cum essem in itinere, quod propter vigentem necessitatem comitatus Catari versus Venecias acceperam, Sanctitatis Vestre littere Ragusii mihi presentante fuerunt quibus, summa cum reverentia a me acceptis et lectis, Sanctitas eadem Johannern Gazulum, Boninum de Tollentis et me deputavit ad colligendam pecuniam a Christi fidelibus erogandam pro consequendis indulgencies jubilei civitati Ragusine eiusque dominio, civitatibus, terris, locis et districtibus subditis concessis et assignandam pro medietate comuni dicte civitatis Ragusii et pro alia medietate Georgio Castriotto, ut in litteris Sanctitatis Vestre de super concessis plenius continetur. Et cum agentes nomine comunis dicte civitatis Ragusii consuissent de modo circa id adhibenda ad exequendam Sanctitatis Vestre voluntatem narrassentque qualiter nonnulla loca eidem civitati supposita peste impresentiarum vexarentur, quomodo etiam civitas ipsa magno in discrimine esset propter differentias inter eam et ducem Stefanum, sibi vicinum, existentes dixissentque propterea predictos Johannem Gazulum et Boninum*

Fondet ndihmëse u bënë gati një vit më vonë dhe në mars të vitit 1452 ipeshkvit Andrea Suma, si prokurator i plotfuqishëm i Skënderbeut, iu dorëzuan në Raguzë, 4893 hiperperë,<sup>39</sup> të cilat ishin grumbulluar me nismën e Selisë Apostolike në krye të së cilës në atë kohë ishte papë Nikolla V. Dorëzimi i kësaj shume të madhe parash, i mbajtur me procesverbal u bë në prani të dëshmitarëve Niksha de Giue, zotit Mark, zotit Nikollë Salomioni, mjeshtrit Gjon Matia, mjek kirurg (*medico ciroicho*), Forte Antoni de Curzola, zotërinjve Luka Martini de Florentia, Ricardo del Ben de Florentia, Filip de Arimino dhe Karlucio Alouisii de Manfredonia,<sup>40</sup> për të cilët nuk kemi të dhëna të tjera por që duhet të kenë qenë patjetër persona të një rëndësie të veçantë qoftë për Republikën e Raguzës, qoftë për Selinë e Shenjtë. Dokumenti i këtij dorëzimi mban

*de Tollentis a civitate ipsa Ragusii abesse, nam alter eorum, silicet Johannes, ad Georgium Castriotti profectus est, alter vero Pisauri infirmatur, que quidem cause magno sint impedimento ad exequendam impresentiarum Sanctitatis Vestre mentem. Nam, si littere indulgenciarum predictarum statim publicarentur, dareturque facultas cuilibet subditorum dicte civitatis ad civitatem ipsam veniendi, non sine gravi periculo illius id fieret, cum plena admodum et populosa sit, essetque sufficiens una sintilla pestiferi morbi totam civitatem ipsam succendere quod, si accideret, civitas ipsa, partim ex his quos mors occuparet, partim ex his qui meiu mortis abirent, destituta et pene vacua remaneret, que res mat&iam prestaret hostibus vicinis, ut forte prave eorum intencionis compotes fierent. Quocirca, cum causas ipsas audivissem et curn necesse esset, ut iter quod inceperam proficerem, suasi civibus predictis, ut a publfcacione ipsa supersederent, supplicarentque Sanctitati Ves-tre, quatenus dignaretur de sua gratia et clementia concedere, ut per aliquos menses supersedere possent a publicacione predicta indulgentiarum, et quod Sanctitas eadem differre dignaretur pro indulgenciis ipsis id spacium temporis, per quod a publicacione ipsa supersedebitur dummodo non excederetur terminus sex mensium a die quo litteras ipsas publicari contigerit. Pro re itaque ipsa, credo cives Ragusinos Sanctitati Vestre supplicaturos. Ego autem Sanctitati Vestre supplico, ut respectibus predictis dignetur hoc civibus ipsis concedere, cum non sine magno periculo et incomodo littere ipse indulgenciarum impresentiarum publicari possint.”*, në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 41; shih edhe përkthimin që e kemi sjellë më sipër të korrigjuar tek: *Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A-III-265, J. Radonić, *Materiale mbi historinë e Skënderbeut (Gjuragj Kastrioto Skanderbeg i Arbania u XV veku)* Beograd: 1942, f. 54-55.

<sup>39</sup> Oliver Jens Schmitt, *Skënderbeu*, përkthyer nga Ardian Klosi, Tiranë: K&B, 2008, f. 141.

<sup>40</sup> DAD, Div. Notariae, vol. XXXVI (1451-1452), fol. 88, në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 51.



Fig. 2: Vula e vogël e Skënderbeut me konturet e saj e gjetur në Raguzë. Burimi: Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti, kopertina e pasme*, K. Frashëri, *Skënderbeu...*, f. 197.

datën 18 mars 1452. Ndër të tjera aty thuhet që paratë ia kishin numëruar Andrea Sumës një për një në dorë vetë argjipeshkvi i Raguzës, Bonino De Tolensis dhe kleriku i lartë Gjon Gazulli, tagrambledhës dhe zbatues i letrës apostolike të nxjerrë me rastin e Jubileut të Shenjtë, dhe se më pas nuk lejohej që të kërkohesh detyrim tjetër nga Skënderbeu e nga trashëgimtarët e tij, dhe as nga ndonjë prokurator i Skënderbeut.<sup>41</sup>

Gjatë periudhës prill-qershor 1459 ka disa dokumente që flasin për tërheqje shumë të ndryshme nga Skënderbeu, nga depozitat që ai kishte lënë në Raguzë, të cilat përmenden gjithsej me shumën 2400 dukatë ari.<sup>42</sup> Pra, këtu nuk bëhet fjalë për paratë të shtetit raguzan apo të tjerëve, por për depozita të vetë Skënderbeut. Dokumentet janë të shkruara nga kancelarët e Skënderbeut në gjuhën sllave dhe për marrjen e këtyre parave janë të ngarkuar Rajan Celnik, Pal Gazulli dhe Ninac Vukosaliq. Dokumenti i parë në lidhje me tërheqjen e këtyre shumave

është i datës 2 prill 1459, dhe Skënderbeu nëpërmjet të dërguarve të tij të lartpërmendur kërkon nga komuna e Raguzës, 500 dukatët e parë.<sup>43</sup>

Më 13 qershor të vitit 1459 (në dokumentin origjinal sllav gabimisht mban vitin 1458<sup>44</sup> dhe që është korrigjuar më vonë nga arkivistët

<sup>41</sup> Po aty.

<sup>42</sup> Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu...*, dok. nr. XX.

<sup>43</sup> DAD, *Diplomata et Acta*, 15 st., fol. 287, në *po aty*, dok. nr. CXLVI; Franz Ritter von Miklosich, *Monumenta Serbica spectantia historiam Serbiae, Bosnae, Ragusii*, Vienna: Apud Guillemum Braumuller 1858, nr. CCCLXXXV, f. 481-482; J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 178. Dokumenti në formë të shkurtuar edhe tek: Ljubomir Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma*, Knjiga I, Dubrovnik i susedi njegovi. Drugi deo. Sredio Ljub. Stojanović. Beograd – Sr. Karlovići: Štampano u Srpskoj Manastirskoj Štampariji 1934, dok. nr. 796, f. 215.

<sup>44</sup> Shih dokumentin më datë 13 qershor 1458 tek: L. Stojanović, *Stare srpske povelje ...*, dok. nr. 795, f. 215.

dubrovnikas<sup>45</sup>), Skënderbeu merr nga komuna e Raguzës një shumë të dytë prej 900 dukatësh dhe si marrës të saj përmenden sërish tre të dërguarit e tij të sipërpërmendur,<sup>46</sup> dhe po më datë 13 qershor 1459 tërhiqet shuma prej 1000 dukatësh ari, të cilat ishin sasia e fundit e depozituar atje<sup>47</sup>. Kjo shumë merret po ashtu nga tre përfaqësuesit e Skënderbeut: Rajani, Pal Gazulli dhe kancelari Ninac Vukosaliq. Në këto dokumente nuk jepen të dhëna për shkaku pse u morën këto të hodha. Aty Skënderbeu përmend edhe “*vulën e unazës sime të famshme*”, për të cilën mendojmë se është e ashtuquajtura vula e vogël, gjurmët e të cilës kanë mbetur në një vulosje me dyll të kuq (shih fig. 2).<sup>48</sup> Por, për çfarë i mori Skënderbeu këto të shuma të hollash? Le t’u hedhim një vështrim të shkurtër ngjarjeve të kësaj periudhe.

Vitet 1458-1459 ishin të karakterizuara nga një periudhë, ku Skënderbeu nuk kishte konflikte dhe gjithashtu i rrinte larg një konfrontimi me osmanët, të cilët po sulmonin Serbinë dhe aleatë të tjerë të tyre. Ato po sulmonin edhe Morenë duke u shkaktuar dëme shqiptarëve që banonin atje. Vetë Papa Piu II, më 3 maj 1459, i shkruan dukës së Burgundisë, se Skënderbeu, “që nuk ka kursyer asgjë për t’u bërë mburojë për Perëndinë dhe besimin katolik, ndoshta për shkak të pamundësisë për të përballuar më tej gjëma shkatërruese, është duke bërë marrëveshje me Turkun”.<sup>49</sup> Pra, ideja e Skënderbeut për të bërë një paqe me Perandorinë Osmane nuk mbeti sekret në Evropë.

---

<sup>45</sup> Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu...*, dok nr. CXLV, ref. 208.

<sup>46</sup> DAD, *Diplomata et Acta*, 15 st., fol. 286, në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu...*, dok. nr. CXLVI; J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 181. Dokumenti në formë të shkurtuar edhe tek: L. Stojanović, *Stare srpske povelje ...*, dok. nr. 795, f. 215.

<sup>47</sup> “*Georgius Castriot, dictus Skender beg, fatetur se a Ragusinis accepisse 1000 ducatos aureos pecuniae apud eos depositae.*”. F. Miklosich, *Monumenta Serbica ...*, dok. nr. CCCLXXXVI, f. 482.

<sup>48</sup> DAD, *Diplomata et Acta*, 15 st., fol. 287, në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, nr. CXLVI; F. Miklosich, *Monumenta Serbica*, nr. CCCLXXXVI, f. 482; J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 182. Dokumenti në formë të shkurtuar edhe tek: L. Stojanović, *Stare srpske povelje ...*, dok. nr. 796, f. 215.

<sup>49</sup> Virgjil Kule, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Kryqtari i fundit*, Tiranë: Ombra GVG, 2011, f. 318. Kule citon një dokument nga Ignatius Parrino, *Acta Albaniae Vaticana: res Albaniae saeculorum XIV et XV atque cruciatam spectantia*, nr. 412, vepër të cilën nuk mundëm ta gjenim.

Barleti flet për një marrëveshje të bërë me Hamurin e Sinamin, por që nuk arriti kurrë që të transformohej në një paqe zyrtare.<sup>50</sup> Hungarezët u përpoqën që të krijonin një front hungarez-serbo-boshnjak kundër turqve ku mendonin që të përfshinin edhe Skënderbeun. Për këtë qëllim mbreti Matias dërgon një misionar, *Stupchus de Nandoralba* tek Skënderbeu, të cilin e sjellin anijet raguzane.<sup>51</sup> Ai qëndron tek Skënderbeu gjatë muajve shkurt-mars 1459.<sup>52</sup> Mbi bisedimet e bëra ndërmjet tij dhe Skënderbeut dokumentet që deri tani disponojmë nuk na japin të dhëna, por ka mundësi që ky takim nuk do të ketë pasur rezultatet e pritshme për ta përfshirë Skënderbeun në planet hungareze të frontit të përbashkët antiosman.

Gjatë kësaj periudhe vazhduan përpjekjet për të organizuar një kryqëzatë kundër osmanëve, të cilën e kishte filluar tashmë papa Kaliksti III, i cili vdiq më 6 gusht 1458.<sup>53</sup> Organizimin e mëtejshëm të kësaj kryqëzate e vazhdoi papa pasardhës, Piu II. Në këtë kryqëzatë krahas Skënderbeut dhe pjesëmarrësve të tjerë shqiptarë në luftë, ishin caktuar edhe klerikë shqiptarë, të cilët cilësoheshin si predikues të kryqëzatës. Ndër ta përmenden, ati françeskan Eugjen Suma nga Drishti, i cili ishte bërë nunc (*nuntius et commissarius*)<sup>54</sup> që në kohën e papa Nikollës V dhe në lidhje me Kryqëzatën nga papa Kaliksti i ishin ngarkuar të drejta të shumta.<sup>55</sup> Më tej, përmendet edhe at Gjoni i Arbërisë (*Giovanni d'Albania*), i cili si predikues i kryqëzatës ishte i ngarkuar me të drejta të veçanta në Arbëri.<sup>56</sup> Në Mantova u organizua edhe një Koncil për kryqëzatën. Ky koncil ishte planifikuar që të hapej zyrtarisht më 1 qershor nga papa Piu II. Skënderbeu as në këtë koncil nuk shkoi të merrte

<sup>50</sup> M. Barleti, *Historia e jetës dhe e veprave të Skënderbeut...*, f. 388.

<sup>51</sup> J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 175.

<sup>52</sup> *Po aty*, dok. nr. 177.

<sup>53</sup> Giuseppe Valentini, Matteo Sciambra, Ignazio Parrino, *Papa Kaliksti III, Skënderbeu, Shqipëria dhe Kryqëzata (1455-1458)*. Tiranë: Plejad, 2009, f. 155.

<sup>54</sup> Oliver Schmitt, "Paul Angelus, Erzbischof von Durazzo und seine Bedeutung für den Türkenkampf", në *ΘΗΣΑΥΡΙΣΜΑΤΑ* 30, Istituto Ellenico di Studi Bisantini e Postbisantini, Venezia: 2000, f. 131.

<sup>55</sup> G. Valentini, M. Sciambra, I. Parrino, *Papa Kaliksti III, Skënderbeu, ...*, f. 260-261. Në lidhje me at Eugjen Sumën shih të dhëna të tjera tek: Edmond Malaj, *Drishti, Historia edhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet albanologjike, 2015, f. 77.

<sup>56</sup> G. Valentini, M. Sciambra, I. Parrino, *Papa Kaliksti III, Skënderbeu, ...*, f. 261.

pjesë. Gjatë këtij viti ai e kaloi kohën duke bërë meremetime dhe duke i dhënë kohë ekonomisë që të ripërtërihej.<sup>57</sup> Pikërisht për këtë arsye duhet të ketë përdorur edhe 2400 dukatët që nxori [nga “bankat”] e Raguzës. Për këto punime dhe ndërtime Barleti shprehet si më poshtë:

“Skënderbeu gjatë kësaj kohe, pa turbulluar gjëkund paqen me Hamurin e Sinamin, përveç ndonjë rasti kur furia e ushtarëve vepronte me kokë të vet, duke vizituar herë Dibrën, herë vendet e tjera të krahinës, bëri shumë ndërtime të dobishme dhe të bukura për krahinarët, sidomos në Mat, ku shumë monumente të të vjetërve, të sheshuara gërmadhë përdhe po prisnin të rindërtoheshin”.<sup>58</sup>

Paqja e mësipërme që përmend Barleti duhet të kuptohet si armëpushim, pasi Sulltan Mehmeti II, siç thotë edhe vetë Barleti, me gjithë përpjekjet që bënë Hamuri me Sinamin, paqen zyrtare me Skënderbeun ai nuk e arriti, por në vend të saj u bë vetëm një *paqe e veçuar*.<sup>59</sup>

Skënderbeu ka qenë në Raguzë për herë të dytë në vitin 1461 dhe për të tretën në vitin 1462.<sup>60</sup> Kjo përkon me kohën e udhëtimit të tij në Itali, ku në mbretërinë e Napolit bën fushatën ushtarake për të ardhur në ndihmë mbretit Ferdinand i Napolit, të birit të mbretit Alfons tashmë të vdekur. Qoftë mbërritja në Raguzë në vitin 1461 dhe nisja për në Pulia, qoftë kthimi nga Italia dhe qëndrimi i Skënderbeut në Raguzë për një kohë relativisht të gjatë, janë të dokumentuara mjaft mirë.

Raguzë po bënte përgatitje serioze për të pritur Skënderbeun me nderimet dhe me kushtet ashtu si ai e meritonte dhe më 23 gusht 1461, Këshilli i Vogël i Republikës së Shën Vlashit cakton zotërinjtë *Palladin de Lukaris, Paulus Ni. Jo. De Poza* dhe *Nikola de Palmota*-n si zyrtarë që duhet ta pritnin me nderime e ta shoqëronin Skënderbeun që po vinte<sup>61</sup>. Një ditë më vonë caktohet edhe shtëpia, ku Skënderbeu do të akomodohej, e cila i përkiste fisnikut Junius de Gradi.<sup>62</sup> Skënderbeu arriti

<sup>57</sup> V. Kule, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu ...*, f. 326.

<sup>58</sup> M. Barleti, *Histori e Skënderbeut ...*, f. 388.

<sup>59</sup> *Po aty*.

<sup>60</sup> B. Krekić, “Contribution of Foreigners to Dubrovnik’s Economic ...”, f. 388.

<sup>61</sup> DAD, Cons. Minus., Vol. XV, fol. 201, në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 211; shih edhe: Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CLVII.

<sup>62</sup> DAD, Cons. Rog., Vol. XVII, fol. 6v, në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 213; shih edhe: Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, nr. CLVIII.

në Raguzë në fund të gushtit të vitit 1461. Mbërritjen e Skënderbeut, M. Barleti e përshkruan si më poshtë:

“Kur Skënderbeu arriti në Raguzë, u derdh i gjithë qyteti dhe dolën përpara një mizëri populli për ta pritur me duartrokkitje dhe gëzim shumë të madh. I përcjellur prej tyre, ai hyri në qytet dhe u prit me nderime e me bujari. Të nesërmen, pasi u bënë sipas zakonit, kremtime zyrtare dhe ceremoni fetare, i ra qytetit rreth e përqark, ndërsa ditën tjetër vazhdoi duke vizituar arsenalet navale, kështjellën dhe fortifikimet e qytetit. Ditën e katërt, përkundrazi, kaloi me lodra të ndryshme dhe me sehire gjithfarësh. Të nesërmen e shpunë në senat, ku u nderua me shumë dhurata të ndryshme dhe ku u lavdërua zyrtarisht para mbledhjes nga një farë Davidi, shkrimtar raguzan...”<sup>63</sup>

Mbi mbërritjen e Skënderbeut jep të dhëna edhe kronisti raguzan Junius de Resti, i cili shkruan se ai bëri marrëveshje me Republikën e Raguzës, që të lejohej të vendosej me familje në rast se do ta shihte të nevojshme të largohej nga vendi i tij për shkak të kërcënimit turk.<sup>64</sup> Për qëndrimin e tij të përkohshëm aty, Skënderbeu kërkoi që të lejohej të vendosej tek vendi me emrin “Shkëmbi i Merkanës”, por zotërinjtë raguzanë nuk ranë dakord. Si rrjedhim Skënderbeu pranon që të vendoset brenda qytetit të Raguzës, në shtëpinë e përgatitur enkas për të dhe aty i dhanë paratë që kishin mbledhur për kryqëzatën.<sup>65</sup> Meqë po shkonte tek Ferdinandi i Napolit, ai u informua për ngjarjet që po zhvilloheshin ndërmjet Republikës dhe mbretit.

<sup>63</sup> M. Barleti, *Histori e Skënderbeut...*, f. 394.

<sup>64</sup> “*In tanto il Turco faceva progressi. Fu avisato il herzegh delle nuove et al Skenderbegh fu concesso, alla sua dimanda, il ricetto nelle nostre isole con la sua famiglia, se li occorresse alcun sinistro accidente da Turchi*”. “*Chroniche ulteriori di Ragusa. Probabilmente Opera di Giovanni di Marino Gondola*”, në *Monumenta spectantia Historiam, Slavorum Meridionalium*. Volumen XXV. *Scriptores* Volumen II. *Chronica Ragusina Junii Restii (Ab origine urbis usque ad annum 1451)* item Joannis Gundulae (1451-1484). Zagabriae: Ex officina Societatis Typographicae, 1893, f. 359.

<sup>65</sup> “*Ma egli desiderava, che se gli concedesse il scoglio di Mercana; ma li Signori, non parendoli bene, si scusarono, confermandoli la prima concessione delle isole nostre. Egli, havuta questa concessione, si trasferì fra pochi giorni a Ragusa, e dalli Signori fu alloggiato in una casa a tal effetto aparecchiata, e datili tutti li danari della cruciata raccolti.*” *Po aty.*



Gjatë kësaj kohe Skënderbeu bëhet ndërmjetës edhe për lirim nga dënimi me vdekje të një vrasësi, i cili mesa duket i interesonte Ferdinandit të Napolit. Emrin e vrasësit dokumentet nuk e japim por i përmendim atësinë. Ai është i dokumentuar si i biri i Nikolaus Rusinoviçit (*Nicolai Russinovich*) dhe ndodhej në burgun e Raguzës për vrasje pasi nuk i ishte bërë akoma gjykimi.<sup>66</sup> Për këto bisedime tek Skënderbeu dërgohen ambasadorët, Bartolo Gozze dhe Nikolla de Marino Gondo, ndërsa Napoli kishte dërguar të quajturin Parpanjano.<sup>67</sup>

Skënderbeu këtë punë diplomatike ndërmjet dy shteteve e kryen me sukses. Për hatër të tij dhe të mbretit të Napolit vrasësi lirohet me kusht, që ai të shkonte të pajtohej me familjen e të vrrarit.<sup>68</sup> Pas këtyre punëve, Skënderbeu bëhet gati të niset për në Pulia, së bashku me familjen e tij me anë të anijeve raguzane.<sup>69</sup> Atij, iu dhanë edhe 2000 peksimadhe (*duo miliaria bischoti*),<sup>70</sup> krahas parave të dorëzuara që ishin mbledhur për kryqëzatën. Kjo punë i ishte ngarkuar më 19 gusht 1461, zotit Françesk Penesa (Penessa).<sup>71</sup>

<sup>66</sup> DAD, Cons. Rog., Vol. XVII, fol. 6v.: “[...] offerendi suprascripto domino Schenderbegh ... vitam filii Nicolai Russinovich, qu est in carceribus nostris quia sit incilpatus homicidii” në J. Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 213.

<sup>67</sup> G. M. Gondola, “Chroniche ulteriori di Ragusa ...”, në *Monumenta ...*, vol. XXV, f. 359.

<sup>68</sup> “Doveva passar dal re Ferdinando. Fu informato delle cose, che passavano tra la repubblica et il re’ perche sappia dire a lui quanto occorreva in giustificatione delli Ragusei. E gia la repubblica li haveva mandato ambasciatori Bartolo Gazze e Nicola di Maritio Gondola, et il re a Ragusa haveva mandato il suo, che era il Signore Parpagnano, per intercedere che fosse lasciato un homicida, il quale non haveva ancora havuto sentenza capitale. Fu in grafia del re e d’esso Skenderbeg liberato, con conditione, che, non havendo havuto sentenza per all’hora, debba prima rappacificarsi con li consanguinei dell’ amazzato”. Po aty, f. 360; shih edhe: DAD, Cons. Rog., Vol. XVII, fol. 6v., në J. Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 213.

<sup>69</sup> “Fu promesso al Skenderbegh la missa per lui e per tutti li suoi nel suo andare. Ma li Catalani non desistendo far danni alli nostri, furono armate due galere per andarli contra.” G. M. Gondola, “Chroniche ulteriori di Ragusa ...”, në *Monumenta ...*, vol. XXV, f. 360.

<sup>70</sup> DAD, Cons. Rog., Vol. XVII, fol. 6v, në J. Radonić, *Durađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 213.

<sup>71</sup> “Skënderbeu në Raguzë”, dok. nr. 33, në Fan S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu 1405-1468*, Tiranë: Naim Frashëri, 1967, f. 245.

Skënderbeu kësaj radhe nuk ndenji gjatë në Raguzë, sepse më 25 gusht 1461 njoftohet arritja e pesë anijeve me njerëzit e Skënderbeut në Barleta, në mes të cilëve thuhet se ishte edhe ai vetë.<sup>72</sup> Nëse kjo datë nuk është e saktë atëherë mbërritja e tij duhet të ketë qenë ndonjë ditë më vonë. Si të pranishëm gjatë këtij udhëtimit Barleti përmend edhe kryeipeshkvin e Durrësit Pal Engjëllin, i cili mban edhe një fjalim para senatit dhe qytetarëve të Raguzës.<sup>73</sup>

Pas fushatës italiane që zgjati disa muaj, Skënderbeu u nis sërish për në Shqipëri. Në janar të vitit 1462, mori një letër nga e shoqja, e cila i kishte çuar lajmin se turqit i ishin afruar kufirit, kështu Skënderbeu merr rrugën e kthimit.<sup>74</sup> Marin Barleti nuk jep asnjë të dhënë për udhëtimin dhe qëndrimin e Skënderbeut në Raguzë, por thotë se Skënderbeu, “... pasi dërgoi më parë në anijet dhe trimet që ishin në portin e Tranit, pjesën më të madhe të ushtrisë dhe ushtarëve të tij ... dhe pasi priti për një lundrim të mirë erën e mbarë, u nis pastaj me një herë nga brigjet e Apulisë dhe arriti me tërë ushtrinë shëndosh e mirë me anijet, që po dilnin pjesërisht në limanin e Durrësit.”<sup>75</sup> Pra, nga Trani, Skënderbeu, sipas Barletit, niset drejt e në Durrës. Faktet tregojnë që Skënderbeu më parë u ndalua në Raguzë ku duhet të ketë qëndruar për disa ditë.

Kësaj here ai duhet të ketë arritur atje më 6 shkurt 1462,<sup>76</sup> por përgatitjet për pritjen e tij bëhen shumë ditë para mbërritjes. Këto përgatitje konsistojnë në caktimin qoftë të njerëzve që do të merreshin me të, qoftë të shumës që do të shpenzohej për ushqimin dhe shpenzime të tjera, si dhe të njerëzve që do ta shoqëronin atë gjatë largimit të tij nga kjo Republikë.<sup>77</sup> Skënderbeu qëndron në Raguzë për disa ditë, deri më 11

<sup>72</sup> F. S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, f. 123.

<sup>73</sup> M. Barleti, *Histori e Skënderbeut ...*, f. 395.

<sup>74</sup> F. S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, f. 126.

<sup>75</sup> M. Barleti, *Histori e Skënderbeut ...*, f. 416-417.

<sup>76</sup> F. S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, f. 126.

<sup>77</sup> *Diplomatarium Relationum Reipublicae Ragusanae cum Regno Hungariae*. Ragusa és Magyarországnak összeköttetésének oklevéltára. A raguzai állami, a bécsi cs. és kir. titkos és egyéb levéltárakban levő okiratokból összeállította Gelcich József. Bevezetéssel és jegyzetekkel ellátta Thallóczy Lajos. Budapest: Kiadja a M. Tud. Akadémia Tört. Bizottsága 1887, dok. nr. 17, f. 753-754 (Në vazhdim cituari si: J. Gelcich, L. Thallóczy, *Diplomatarium Ragusanum*, f. ); shih edhe: Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CLXII-CLXXIV.

shkurt 1462.<sup>78</sup> Për shoqërimin e tij caktohet edhe një delegacion që përbëhej nga fisnikët Bartolus de Gozze, Jacobus Marini de Gondola dhe Mikael de Volto.<sup>79</sup>

Mesa duket ai kishte dashur të nisej edhe më parë, por ngaqë moti ishte i keq, organet shtetërore i kërkojnë më 8 shkurt që ta zgjasë qëndrimin dhe marrin masa edhe për furnizimin e ushtarëve të tij që ndodheshin në Caftat, duke vënë në dispozicion si ushqim peksimadhe dhe shumën e 50 hiperperëve për shpenzime të tjera.<sup>80</sup> Më datë 9 shkurt ata, madje, bëjnë edhe bisedime me Skënderbeun në lidhje me zhvillimet në Ballkan.<sup>81</sup> Para datës së nisjes ai arrin që të bëjë edhe një marrëveshje për lirimin e disa shqiptarëve që ishin zënë robër në afërsi të ishullit të Lagostas dhe kishin rënë në burgjet e Raguzës.<sup>82</sup> Pra, siç u tha edhe më sipër, më 11 shkurt u bë edhe nisja e Skënderbeut dhe anijet që do të transportonin shqiptarët u furnizuan me 300 libra bukë peksimadhe.<sup>83</sup> I deleguari i Gjergj Kastriotit, i cili ndërmjetësoi për punët e kthimit ishte Andrea Gazulli.<sup>84</sup>

Në vitin 1466, Skënderbeu po rrezikohej nga një ushtri e madhe osmane e drejtuar nga vetë sulltan Mehmeti që po përgatitej të vinte në

<sup>78</sup> F. S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, f. 126.

<sup>79</sup> DAD, Acta Cons. Min., Vol. XV. (1459-1462), fol. 228v., në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CLXIII.

<sup>80</sup> "8. Februarii. Exhortando dominum Schenderbegh, quod attentis contrariis temporibus, propter que non potest prosequi navigacionem suam, sibi placeat redire Ragusium. Per 33 contra 12. - De scribendo comiti Canalis, quod provideat, ut homines Canalis habentes vinum, animalia et alias res cibarias venales. debeant ea deferre ad Captat, ut homines Schenderbeghi habeant commoditatem. Per omnes. - Libertatém rectori etc. si Schenderbegh nolet redere Ragusium, de mittendo nobilibus nostris, qui sunt apud eum, ipperperos 50 pro expensis, et de bischoto, quantum ipsis videbitur. Per 35 contra 1". J. Gelcich, L. Thallóczy, *Diplomatarium Ragusanum ...*, dok. nr. 17, f. 754.

<sup>81</sup> DAD, Acta Cons. Rog., Vol. XVII, fol. 6v., në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CLXXII.

<sup>82</sup> "11. Fevruarii. De donando illustri dominó Schenderbegh, qui dominium nostrum de hoc instanter rogari fecit, illos quinque homines. qui sünt in carceribus nostris. alias per piscatores nostros interceptos ad insulam Laguste de fusta Baroli. Per 33 contra 1." J. Gelcich, L. Thallóczy, *Diplomatarium Ragusanum ...*, dok. nr. 17, f. 754.

<sup>83</sup> J. Gelcich, L. Thallóczy, *Diplomatarium Ragusanum ...*, dok. nr. 17, f. 754.

<sup>84</sup> DAD, Acta Cons. Rog., Vol. XVII, fol. 6v., në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CLXV.

drejtim të Ballkanit Perëndimor. Ai kishte arritur tashmë brenda 4 ditëve deri në Shkup dhe po bëhej gati të vinte në drejtim të Skënderbeut. Këtu nuk po ndalemi në detajet e këtyre ngjarjeve, por në lidhje me to duhet të përmendim që edhe Raguzë mori masat e saj për t'i dhënë një ndihmë Skënderbeut në rast se ai do të detyrohej që të linte trojet e tij për shkak të pushtuesit. Për këtë, më 18 prill 1466, Senati i Raguzës merr vendim që t'i ofrojë Skënderbeut ishullin Mljet për strehimin e tij dhe të familjes në rast rreziku.<sup>85</sup> Po ashtu, krahas ndihmave me armatime, me barut për bombardat, nitratin potasi dhe squfur<sup>86</sup>, atij i ofrohet sërish më 2 maj 1466 përveç ishullit Mljet dhe ishulli i Lagostës për strehim të familjes.<sup>87</sup>

Në fund të vitit 1466, Skënderbeu i afrohet Raguzës, gjatë udhëtimit për në Itali, ku do të vizitonte Ferdinandin e Napolit dhe do të shkonte edhe në Romë, për shkak të situatës së vështirë që ishte krijuar qoftë nga osmanët, qoftë edhe nga venedikasit. Ai arrin në portin e Raguzës në fund të tetorit apo në fillim të nëntorit. Më 2 nëntor 1466, Këshilli i Vogël cakton si ambasadorë të tij fisnikët *Ser Nicola Mar. de Gondola*, *Ser Aloysius de Giorgio* dhe *Ser Helias Pe. de Bona*, të cilët ishin porositur nga Senati që ta takonin Skënderbeun<sup>88</sup> dhe të merreshin vesh me të, nëse ishte më e udhës që ai të mos zbriste në Raguzë, “*për disa arsye të mira*”, të cilat, në dokument nuk përmenden.<sup>89</sup> Nën kompetencat e rektorit të Këshillit të Vogël ishte lënë detyra e furnizimit të Skënderbeut me ushqime “*sa të ketë mundësi dhe sa të ketë dëshirë*”<sup>90</sup> dhe thuhet gjithashtu, që fusta\* e Skënderbeut lejohej vetëm të futej

<sup>85</sup> DAD, Acta Cons. Rog., Vol. XVIII, fol. 150: “*Die XVIII Aprilis 1466, Prima pars est de offerendo illustri domino Schenderbegho receptaculum pro familia sua in insula nostra Melite, progut alias fuit. Captum per 17:14.*” në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 314.

<sup>86</sup> DAD, Acta Cons. Rog. XIX (1466-1467), fol. 42v: në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CCXIII.

<sup>87</sup> DAD, Acta Cons. Rog. XIX (1466-1467), fol. 42v-43v: në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CCXVIII.

<sup>88</sup> DAD, Acta Cons. Rog. XXII, fol. 40v, në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 337.

<sup>89</sup> DAD, Acta Cons. Rog. XIX, fol. 134r-134v: J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 314; krahaso edhe: V. Kule, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, f. 472.

<sup>90</sup> DAD, Acta Cons. Rog. XIX, fol. 134r-134v: J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 314; Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CCXVIII.

\* *fusta* - tip anijeje në Mesjetë.

brenda zinxhirëve të portit. Ky protokoll kaq i shkurtër në lidhje me pritjen e Skënderbeut kësaj here kishte të bënte me llojin e vizitës së tij, e cila ishte transite dhe e shkurtër dhe se destinacioni final i Skënderbeut nuk ishte Raguzë, por vetë Italia. Skënderbeu ishte ndalur aty mesa duket vetëm për të marrë të birin, Gjinin, dhe për t'u furnizuar. Në të tilla raste duket se nga Republika e Raguzës përdoreshin të tilla protokolle të cilat ishin të gatshme sipas llojeve të vizitave.<sup>91</sup> Nëse Skënderbeu do të zbriste, qoftë edhe për pak kohë, kjo do të kërkonte një ndryshim të krejt protokollit gjë që do t'i sillte republikës shpenzime të kota. Për vizitën e të birit të Skënderbeut, dokumentet që disponojmë nuk japin të dhëna. Pra, siç e pamë, Skënderbeu shkoi në Raguzë pothuajse, një vit para vdekjes së tij, më 17 janar 1468.

Në dokumentet raguzane ka edhe prej tyre që flasin për vdekjen e Skënderbeut. Në një dokument të datës 1 mars 1468, thuhet se Skënderbeu kishte vdekur nga një shigjetë. Dokumenti në fjalë është nisur nga Raguzë për në Mantova dhe është një letër e shkruar e Giovanni Francesco de Maffei, ambasadori mantovan në Raguzë, i cili ia drejton këtë letër markezit të Mantovas. Krahas të tjerash, në letër thuhet, që turqit kishte shkuar dhe në Shkodër, pra në zonën venedikase, ku kishte bërë pre të madhe dhe grabitur shumë gjëra, burra, gra e fëmijë, duke i shkaktuar krahinës së Shkodrës shumë dëme.<sup>92</sup>

Këto ishin vetëm disa të dhëna paraprake në lidhje me marrëdhëniet më tepër të natyrës diplomatike dhe politike, ndërmjet Kastriotëve kryesisht Skënderbeut dhe Republikës së Raguzës, të cilat do të paraqiten në të ardhmen edhe më të zgjeruara e me informacione të reja.

Le t'i hedhim tani një vështrim përmbledhës edhe marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare.

---

<sup>91</sup> V. Kule, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, f. 473.

<sup>92</sup> V. Makushev, *Monumenta historica slavorum ...*, vol. II, f. 32-33; "Dubrovnik. 1. Mart. 1468: PS. Scanderbeg e stato morto in bataglia cum una freza. El Turcho e venuto insino a Scutari de Venecia e fece grande preda de robia et homini e donne et fanciulli. Ha fatto uno grande danno.", në J. Radonić, *Đurađ Kastriot Skenderbeg ...*, dok. nr. 391; shih edhe: Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CCXXVIII.

## Marrëdhënie tregtare dhe ekonomike

Kastriotët kishin me Republikën e Raguzës edhe marrëdhënie tregtare të qenësishme. Dokumentet na dëshmojnë edhe për intensifikim të këtyre marrëdhënieve në fillim ndërmjet Gjon Kastriotit dhe Raguzës e më pas edhe me Skënderbeun. Një dokument i tillë mban datën 25 shkurt 1420. Aty Gjoni së bashku me bijtë e tij zotohet që t'u lejojë tregtarëve raguzanë që të kalojnë nëpër territorin e tij dhe të bëjnë tregti edhe në Shufadë që aso kohe ishte nën zotërimin e tij.

“un zotni Gjini [Gjoni] ap besen n'êmen t'êm e të bijve të mij çë do tregtari të republikës së qytetit të Raguzës qi ká me dashtë të vîjë në token t'eme qi thirret Shufada a se qi ká me dashtë të bâjë tregti në token t'eme a por ka me dashtë të kalojë neper Shtetin t'êm në token e Gjergjit a se të zotni Despotit, kështu po u ap besen qi porsa të vîjn në token tëme Shufadaj po bâni e u ndodhi gjâ e keqe deri në Prezrend, un zotni Gjini e bijt e mij kemi me u a shperblye. Me ket ligjë caktohen të dhattat e të hîmit mbasi kemi rá në godi me mikun t'êm e vllán t'uej Pjetrin; në mbarë token t'ême s'keni me la veç një të dhetë d.m.th per një kvintal cohë kan me u la dy dukat e per një kvintal grûn një perper. Në token e Turkut, Radunje, ká me u la një gjysë dukati per cohë e per gûn gjashtë dinarë. Per percjellsa në token t'ême deri në Shufadaja ká me u la per mâ teper një perper per dýll, inbul (?) e per tjera sende; në Radunje por kan me i u la Turkut gjashtë dinarë. Në tanë këtë (kje pranë) kryetari i financave Pjetri (venecjan). Shkrue vjetin 1420 me 25 fruer”.<sup>93</sup>

Siç shihet edhe në dokument, Gjoni u premton mbrojtje dhe siguri tregtarëve raguzanë deri në Prizren dhe në këmbim të kësaj sigurie ai kërkon vetëm një të dhjetën, duke dhënë edhe specifikime si p.sh.: për një kuintal cohë dy dukatë dhe për një kuintal grurë 1 hiperper. Kjo u jepte lehtësi dhe siguri tregtarëve, sepse ndodhte që tregtarët kur kalonin nëpër territoret e huaja, ishin të detyruar të paguanin disa herë dhe më tepër.

Ndër marrëdhëniet tregtare mund të përfshijmë këtu edhe marrje me qira të anijeve raguzane nga ana e Gjon Kastriotit dhe njerëzve të tij për

<sup>93</sup> Dokumenti sllavisht përkthyer në shqip nga at Gjon Shllaku OFM: *Shqyptari – Frati – Shqypnija*, përgatitën për botim: Átë Vitor Demaj, OFM, Prof. dr. Aljula Jubani, Átë Mirash Marinaj, OFM, Shkodër: Botimet Françeskane, 2018, f. 106-107.

të transportuar mallra dhe njerëz. Një rast i tillë përmendet më 31 maj 1426, ku njerëzit e Gjon Kastriotit marrin një anije me qëllim që të shkojnë në Ankonë.<sup>94</sup>

Vendimet që ishin marrë më parë për doganat, shihen edhe një herë në vitin 1430, por nga bisedimet që qenë bërë në lidhje me këtë çështje në janar të këtij viti, me sa duket mbesin në fuqi vendimet doganore të mëparshme.<sup>95</sup> Si ambasador i Gjon Kastriotit përmendet Nikollë Suma, i cili nderohet edhe nga Raguza duke iu dhuruar 50 hiperperë në pëlhurë dhe 150 në argjend “për zotërinë e tij Gjon Kastriotin”.<sup>96</sup> Shufadâ më pas kalon në duart e turqve dhe në shtator të vitit 1430, raguzanët mundohen të kontaktojnë palën turke me qëllim që të krijojnë sërish lehtësira për kalimin e mallrave qoftë në atë pikë, qoftë në të gjitha rrugët që kalonin nëpër territoret e zotëruara nga osmanët, sepse ata me sa duket kishin urdhëruar që të shmanget transporti i mallrave nëpër krahinën e dikurshme të Gjon Kastriotit.<sup>97</sup>

Mësymjet i kishin ardhur Gjon Kastriotit nga ekspeditat turke që ishin shkaktuar nga shkuarja e Stefan Maramontes te sulltan Murati II, nga i cili kishte marrë trupa për të dëmtuar krahinat në Arbëri dhe në Zetë që ishin nën zotërimin e Venedikut. Trupat turke kishin shkaktuar dëme të mëdha dhe kishin pushtuar përkohësisht edhe qytetin e Drishtit, por jo kështjellën. Një pjesë e ushtrisë turke kishte kaluar edhe nëpër zotërimet e Gjon Kastriotit, ku kishte marrë edhe katër fortesa, të cilat më pas ishin rrafshuar përdhe,<sup>98</sup> kurse në dy kështjella të tjera u vendosën trupa osmane.<sup>99</sup> Komandanti i këtyre trupave quhej Isak, që ishte qeveritari osman i Shkupit. Gjon Kastrioti u përpoq që të merrej vesh me ta dhe në fakt ia doli që të rimerre trojet e tij, me përjashtim të një zone të vogël, e cila mbeti nën zotërimin e Isakut.<sup>100</sup>

---

<sup>94</sup> DAD, Acta Cons. Rog., vol. III, fol. 300v, në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. X.

<sup>95</sup> DAD, Acta Cons. Min., vol. IV (1426-1438), fol. 186, në *po aty*, dok. nr. XX.

<sup>96</sup> DAD, Acta Cons. Min., vol. IV (1426-1438), fol. 186, në *po aty*, dok. nr. XXI.

<sup>97</sup> DAD, Lett. et Comm. di Lev., vol. X (1426-1430), në *po aty*, dok. nr. XXXVIII.

<sup>98</sup> DAD, Lett. et Comm. di Lev., vol. X (1427-1430), fol. 138v, në *po aty*, dok. nr. XXXVIII.

<sup>99</sup> L. von Thallóczy, K. Jireček, “Zwei Urkunden ...”, f. 140.

<sup>100</sup> *Po aty*.

Kjo është pikërisht periudha që përmendëm edhe më sipër, ku sulltan Murati pushtoi Selanikun (1430), dhe që pas rënies së këtij qyteti u mund edhe Gjon Kastrioti dhe së bashku me të bijtë kishte pranuar edhe Islamën dhe që pas kësaj ngjarjeje djemtë e Gjon Kastriotit ishin të detyruar të merrnin pjesë edhe nëpër ekspedita ushtarake.<sup>101</sup> Gjatë kësaj kohe marrëdhëniet me Raguzën e me vendet e tjera të krishtera pësojnë një rënie.<sup>102</sup>

Këto të dhëna janë nxjerrë pikërisht nga dokumentet raguzane, kryesisht nga një letër e datës 18 maj 1430 e Senatit të Raguzës drejtuar Benedetto Mar De Gondola, ambasadorit raguzan të dërguar pranë Sandalit, vojvodës së madh të Bosnjës,<sup>103</sup> dhe nga një letër tjetër drejtuar po Gondolas më 28 maj të atij viti, në të cilën marrim vesh madje që vetë sulltan Murati ndodhej në Janinë duke luftuar në këto krahina.<sup>104</sup> Zona e vogël që kishte mbetur nën zotërimin e Isakut, ku mbase përfshiheshin dy kështjellat, të cilave nuk u përmendet emri, do t'i shërbente ushtrisë turke për të luftuar kundër despotit të Janinës.<sup>105</sup> Prej letrës së 3 qershorit 1430

<sup>101</sup> F. S. Noli, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu...*, f. 77.

<sup>102</sup> *Po aty*, f. 96.

<sup>103</sup> Letër e datës 18 maj 1430 e Senatit të Raguzës drejtuar Benedetto Mar De Gondola: "*De nouvelle abbiamo questo. Come auanti fo scritto. lo Turcho obtegnj Salonicho et obtegnudo che l'aua, parte delle sue gente mando nella Morea e parte contra le tenute e paexe de Iuan Castrioto. lequal ad esso Iuan leuorno quatro forteze, zoe castelle, che gitorno per terra, et secondo se diceua, esso Iuan cerchaua sego achordo. Que de più sia seguito, perche nostre barche non son venute questi di de là, non sapiamo dir.*" L. von Tallóczy, K. Jireček, "Zwei Urkunden ...", f. 140.

<sup>104</sup> Letër e datës 28 maj 1430 e Senatit të Raguzës drejtuar Benedetto Mar De Gondola: "*De nouvelle altro non abbiamo, ne ma che li Turchi de li quali per altre vi scriuissimo, anno auuto tutta la contrada de Iuan Castrioto e anno gitado per terra tutte le forteze, excepto duo, le qual per se anno fornito e . . . Et parte della contrada e datta a Turchi e parte n'è lassada al dicto Iuan. Lo imperador se ritroua sotto la Janina e guerexa quelle contrade, che forno del dispoth Exau e del dispoth del Arta.*" *Po aty*, f. 140-141.

<sup>105</sup> Letër e datës 3 qershor 1430 nga Raguzë drejtuar Nicolo Michael de Resti, ambasador pranë mbretit të Bosnjës: "*Di noue di qua se dice, el Turcho auer tolto tute le forteze a Iuan Castrioti e quelle auer ruinato excetto due, le qual a posto in man e guardia di Turchi e la contrata auer renduta a Iuan, saluo alguna particella, data a Isach, e la hoste mazor parte a licentiado, excetto una particula, chi e rimasta a guerizar el despoto de la Janina, e lo imperador e andato in Andrinopoli con la sua corte.*" *Po aty*, f. 141.



nga Raguza, drejtuar Nicolo Michael de Resti, ambasador pranë mbretit të Bosnjës, mësojmë gjithashtu që sulltan Murati nuk ndodhej më në Janinë por ishte kthyer në Adrianopojë.

Disa muaj më vonë, më 19 janar 1431, Raguza jep një udhëzim për t'iu përgjigjur sa më mirë letrave të kontkapitenit të Shkodrës, doganierëve të Dejës dhe Gjon Kastriotit, në lidhje me doganën e Dejës dhe me rrugët tregtare.<sup>106</sup> Meqenëse aty jepet vetëm ky fragment nuk mund të dimë mbi përmbajtjen e këtyre përgjigjeve, por që shohim edhe një herë, se Gjon Kastrioti e kishte sërish tashmë kontrollin mbi territoret e tij dhe donte të bisedonte prapë me raguzanët për taksat doganore.

Nëpër dokumente paraqiten raste ku tregtarët raguzanë dhe pronarë anijesh shkojnë në territoret e Kastriotëve për të blerë mallra të ndryshme dhe dru. Një rast i tillë është i dokumentuar më 25 gusht 1428, ku flitet për anije raguzane që i drejtohen lumit Ishëm për të ngarkuar dru.<sup>107</sup>

Përveç Shufadës së lartpërmendur një pikë tjetër e rëndësishme për importin dhe eksportin e mallrave ishte edhe Ishmi. Sipas Jireček, ky vend ishte një stacion i rëndësishëm tregtie, i pajisur edhe me një pikë portuale që ekzistonte në grykëderdhjen e këtij lumi (Ishmit), ku në Mesjetë prodhoheshin edhe anije.<sup>108</sup> Port lumor ndodhej edhe në grykëderdhje të lumit Mat, ku me sa duket kishte edhe një treg me rëndësi për kohën. Aty ishin vendosur tregtarë dhe ndërmjetës raguzanë që nëpërmjet këtij porti importonin dhe eksportonin një shumëllojshmëri mallrash.<sup>109</sup> Emrat e këtyre dy vendeve të ndodhura në grykëderdhjet e lumenjve Jireček, nuk i përmend.

Më 7 tetor 1429 përmendet edhe raguzani Blasius Michaelis de Umbla, i cili ngarkohet me detyrën që të shkojë nëpër porte të ndryshme

---

<sup>106</sup> DAD, Acta Cons. Rog., vol. IV (1427-1432): "(...) *Respondere litteris comitis Scutari, dohanerium dohane Dagni et Iuan Castriot, prot eis melius uidebitur, scrpitis pro dogana Dagni et via mercatorum nsotrorum.*", në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. XL.

<sup>107</sup> DAD, Acta Cons. Min., vol. IV (1426-1429), fol. 186, në *po aty*, dok. nr. XVI.

<sup>108</sup> C. Jireček, "Die Lage und die Vergangenheit der Stadt Durrazzo im Mittelalter", në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 153.

<sup>109</sup> Po aty.

të Arbërisë, ndër të tjera edhe në Ishëm për të ngarkuar mallra.<sup>110</sup> Aty raguzanët kishin vendosur ndërmjetësit dhe druvarët e tyre për prerjen dhe transportimin e drurit. Një rast i tillë përmendet në një dokument të datës 14 janar 1430, ku bëhet fjalë për druvarë raguzanë, të quajtur Alegretus Bogieçieviq (Alegretus Bogiechieuich), i cili lidh kontratë me speciarin raguzan Johan Riçin që të shkojë për dy muaj në Ishëm dhe në vende të tjera me qëllim që të presë e të ngarkojë dru.<sup>111</sup>

Ishmi pra, që ishte pjesë e territoreve të Kastriotëve përmendet vazhdimisht nëpër dokumentet raguzane në lidhje me aktivitetet tregtare kryesisht me eksportimin e lëndës së drurit, por edhe të drithit ndërmjet Raguzës dhe trojeve arbërore. Në lidhje me transportin e drithit duhet të përmendim këtu një rast në vitin 1464 në kohën e Skënderbeut, ku tre përfaqësues të familjes së njohur fisnike Gondola (Gundolić) blenë sasi të mëdha drithi dhe nga kjo shitje Skënderbeu mori 1450 dukatë.<sup>112</sup> Mallra të tjera që dilnin nga ky port për llogari të Skënderbeut ishin edhe fasulet, derrat dhe kripa. Raguzanët nga ana e tyre sillnin në trojet e Kastriotëve prodhime të ndryshme artizanale. Për shembull, në dokumente përmendet emri i tregtarit raguzan të stofrave Bozhiq Pavllloviq, i cili lejohej t'i shiste këto stofra vetëm në trojet e Skënderbeut.<sup>113</sup>

Një aspekt tjetër i rëndësishëm ekonomik ishin edhe doganat. Ato përmenden qoftë në kohën e Gjon Kastriotit ashtu edhe për periudhën e Skënderbeut. Doganat, Skënderbeu ua jepte me qera atyre që ofronin më shumë. Konkurrentë për to ishin venedikasit dhe raguzanët. Kur Skënderbeu ua jepte ato, njëerës palë, mundahej që të mbante larg palën tjetër. Si shembull, mund të sjellim një dokument të shtatorit të vitit 1462, ku Senati i Venedikut i ankohet Republikës së Raguzës në lidhje me këtë çështje, si më poshtë: “Mësuam se njerëzve tanë para pak kohësh, u është ndaluar të eksportojnë drithë nga tokat dhe pikat e Skënderbeut. ...Kjo risi ka ndodhur ngaqë disa prej qytetarëve tuaj kanë

<sup>110</sup> DAD, Div. Cancellariae, vol. XLVI, fol. 53, në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. XVI.

<sup>111</sup> DAD, Div. Cancellariae, vol. XLVI, fol. 53v, në *po aty*, dok. nr. XVIII.

<sup>112</sup> Oliver Jens Schmitt, *Skanderbegeg. Der neue Alexander auf dem Balkan*. Regensburg: Pustet, 2009, f. 107.

<sup>113</sup> DAD, Acta Cons. Rog., vol. XVII (1461-1463), fol. 39r, në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, f. 35.

marrë përsipër doganat e tij”.<sup>114</sup> Kjo mosmarrëveshje më pas pati si rrjedhojë edhe një luftë, ku galerat venedikase sulmonin ato raguzane të ngarkuara me drithë.<sup>115</sup>

Nga këto mosmarrëveshje dhe sulmet që u bëheshin anijeve për shkak të tyre, Skënderbeu një herë humbi gjithë ato mallra që përbëheshin nga 26 tonë drithë, 260 kg fasule, 17 derra dhe një herë tjetër përsëri 26 tonë drithë si dhe sasi kripe, të cilat ia kishte shitur në Raguzë një tregtar fiorentinas.<sup>116</sup> Pra, siç e dëshmojnë rastet e lartpërmendura, qoftë sasia e mallit, qoftë sasia e parave që qarkullonin nëpërmjet marrëdhënieve tregtare midis Skënderbeut dhe Raguzës ishte shumë e madhe për kohën. Nëpërmjet kësaj tregtie Skënderbeu siguronte një pjesë të madhe të të ardhurave për shtetin e tij.

### Diplomatët në shërbim të Kastriotëve

Si përfundim, po paraqesim edhe disa profile të atyre personave që bënë të mundur komunikimin e Skënderbeut me Dubrovnikun. Nëpër dokumente hasim disa diplomatë, të cilët mundësojnë marrëdhëniet e Kastriotëve dhe të Skënderbeut në veçanti me Republikën e Raguzës. Këta ishin burra të ditur, në pjesën më të madhe të tyre klerikë, që njihnin mirë gjuhët e vendeve përkatëse dhe artin e diplomacisë e të shkrimit të dokumenteve. Ndër këta kemi mundur të shquajmë personat si më poshtë:

- Nikollë Suma, i cili ishte ambasador në shërbim të Gjon Kastriotit. Ai përmendet nëpër dokumente të ndryshme, si për shembull më 14 janar të vitit 1430, që dërgohet në Raguzë nga Gjon Kastrioti me disa oferta për taksat dhe doganat, dhe i jepet pëlhurë me një shumë parash prej 125 hiperperësh.<sup>117</sup> Përveç kësaj ai nderohet edhe me 50

<sup>114</sup> O. J. Schmitt, *Skënderbeu ...*, f. 155.

<sup>115</sup> *Po aty*, f. 107.

<sup>116</sup> *Po aty*, f. 107-108.

<sup>117</sup> DAD, Acta Cons. Rog. Vol. IV: “1430. *Deliberations des Conseils de Raguse. a) Consilium Rogatorum. 14 janvier 1430. Mention d’un envoyé de «Juni Castriot.» Cet envoyé, nommé Nicola, était venu avec des offres «pro gabellis et dohannis»: on lui donne du drap, etc. pour 125 perpères, le Id. Le 19, on négocie avec lui touchant les douanes; on répète une décision antérieure.” Nicolae Jorga, *Notes et extraits pour servir à l’histoire des croisades au XVe siècle*, Publiés par N. Jorga, Professeur a*

hiperprerë në pëlhurë dhe për Gjon Kastriotin i jepen edhe 150 të tjera në argjend. Këto kontribute janë shënuar po më datë 14 janar të atij viti.<sup>118</sup>

- Rajanin Celnig (Raian Zelnich), për të cilin nuk kemi të dhëna, nëse është klerik apo jo dhe është përmendur nëpër dokumente të viteve 1458-1459.<sup>119</sup>
- Pal Gazulli (Paulo Gazulo)<sup>120</sup>, i cili ishte diplomat, klerik dhe për një kohë të gjatë në shërbim të Skënderbeut. Përmendet gjatë viteve 1452-1459.<sup>121</sup> Pal Gazulli i përkiste një farefisi, të cilin e gjejmë në Arbërinë Veriore dhe në Raguzë. Ato përmenden me mbiemrin *Gozulo* apo *Gozula* dhe e kishin origjinën nga Arbëria.
- Edhe magjistri Gjon Gazulli vinte po nga kjo familje dhe që gjithashtu në shërbim të Raguzës dhe të Skënderbeut. Ai dërgohej tek ky i fundit nga Senati i Raguzës.<sup>122</sup>
- Pal Engjëlli, Kryepeshkv i Durrësit, i cili e shoqëron Skënderbeun në Raguzë e më tej, deri në Itali gjatë udhëtimit që bën ky i fundit për t'i ardhur në ndihmë të Ferdinandit të Napolit.<sup>123</sup>
- Andrea Gazulli<sup>124</sup> ishte një tjetër gazullor, i cili e ushtroi detyrën e

L'Université de Bucarest. Seconde Série. Paris: Ernest Lereux, Editeur 1899, f. 257-258 ; shih edhe: Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. XIX.

<sup>118</sup> DAD, Acta Cons. Rog. Vol. IV (1427-1431); *Acta Cons. Majus, reg. 1428-1433*: "b) *Consilium Majus. 14 janvier 1430. Grâce á «Nicola Summa», ambassadeur adomini Juani Castrioti». Le 18, il obtient cinquante perpères en drap et son maître 150 autres, en argent.* (Arch. D'Etat de Raguse, Rogati, reg. 1427-1431; Majus, reg. 1428-1433.)" në N. Jorga, *Notes et extraits...*, II, f. 258.

<sup>119</sup> DAD, Diplomata et Acta, 15 st., nr. 287, në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CXLVI.

<sup>120</sup> At Giuseppe Valentini, *Vepra III* (Publicistikë, studime dhe tekste), përgatitur nga Ndriçim Kulla dhe Ksenofon Krisafi, përkthyer nga Dritan Thomollari, Tiranë: Plejad, 2006, f. 71-72.

<sup>121</sup> Ljubomir Stojanović, *Stare srpske povelje i pisma*, Knjiga I, Dubrovnik i susedi njegovi. Drugi deo. Sredio Ljub. Stojanović. Beograd – Sr. Karlovići: Štampano u Srpskoj Manastirskoj Štampariji 1934, dok. nr. 795, f. 215; DAD, Diplomata et Acta, 15 st., nr. 287, në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CXLVI.

<sup>122</sup> Edmond Malaj, "Në gjurmë të familjeve fisnike raguzane me origjinë nga trojet shqiptare", në *Studime historike*, nr. 1-2, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2019, f. 15.

<sup>123</sup> M. Barleti, *Histori e Skënderbeut ...*, f. 395.

<sup>124</sup> Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CXC.

ambasadorit të Skënderbeut sidomos në vitin 1462.<sup>125</sup>

- Po ashtu është me rëndësi të përmendim këtu edhe Gjon Gazullin (II)<sup>126</sup> astronomin dhe diplomatit e famshëm<sup>127</sup>, të birin e Gjon Gazullit të lartpërmendur. Gjon Gazulli (II), i njohur me emrin (Johannes Gasulus) (në literaturën kroate i njohur me emrin Ivan Gazulić), qe lindur ose në Gjadër (të Lezhës) më 1400,<sup>128</sup> ose (sipas G. Valentinit) në Raguzë.<sup>129</sup> Ai ishte i vëllai i Palë Gazullit, diplomatit që përmendëm më lart.<sup>130</sup> Gjoni ishte klerik domenikan, kishte studiuar në Raguzë dhe në Padovë deri në vitin 1425<sup>131</sup> dhe qe doktoruar më 31 janar 1430 në artet liberale.<sup>132</sup> Në vitin 1432, ai kishte shoqëruar mbretin hungarez Sigismund në Romë dhe në Sienë,<sup>133</sup> mision diplomatik që ia kishte ngarkuar Republika e Raguzës, e cila më vonë ia ngarkon këtë mision edhe pranë Papës Nikolla V.<sup>134</sup> Misionet e tij diplomatike të ngarkuara nga Republika e Raguzës ishin të shumta. Më vonë ai përfaqësoi edhe interesat e Skënderbeut, qoftë në Raguzë, qoftë në Itali.<sup>135</sup> Në vitin 1433, ai u emërua profesor i matematikës dhe i astronomisë në Universitetin e Padovas. Përveç mësimdhënies, iu përkushtua edhe ndërtimit të instrumenteve të ndryshme për astronominë.<sup>136</sup> Në vitin 1445 magjistri Gjon Gazulli gjendet përsëri në Romë dhe kjo vërtetohet nga një dokument i datës 22 qershor, ku bëhet fjalë për një letërkëmbim ndërmjet tij dhe Republikës së Raguzës.<sup>137</sup> Misionet e

<sup>125</sup> G. Valentini, *Vepra III ...*, f. 71-72.

<sup>126</sup> Shih rreth jetës së tij edhe: E. Malaj, “Në gjurmë të familjeve fisnike raguzane ...”, f. 15-16.

<sup>127</sup> G. Valentini, *Vepra III ...*, f. 72.

<sup>128</sup> Robert Elsie, *A Biographical Dictionary of Albanian History*, New York/London: I. B. Tauris & Co. 2012, f. 162.

<sup>129</sup> G. Valentini, *Vepra III ...*, f. 73.

<sup>130</sup> R. Elsie, *A Biographical Dictionary...*, f. 162.

<sup>131</sup> *Po aty*.

<sup>132</sup> G. Valentini, *Vepra III ...*, f. 72.

<sup>133</sup> R. Elsie, *A Biographical Dictionary...*, f. 162.

<sup>134</sup> G. Valentini, *Vepra III ...*, f. 72.

<sup>135</sup> R. Elsie, *A Biographical Dictionary...*, f. 162.

<sup>136</sup> *Po aty*.

<sup>137</sup> DAD, Acta Cons. Rog., vol. IX (1444-1446), fol. 164, në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. LXXXIV.

tij diplomatike të rëndësishme vazhdojnë edhe pas vdekjes së Skënderbeut. Pasi bëhet mbret i Hungarisë Matia Korvini në vitin 1469 thërret Gjon Gazullin në oborrin e vet. Pra data e vdekjes së tij në vitin 1465 nuk duhet të jetë e saktë.<sup>138</sup> Gazulli nuk shkon në Budapest, por i dërgon Korvinit një vepër të tijën, në lidhje me hulumtimet astronomike që kishte bërë.<sup>139</sup> Datën e saktë të vdekjes nuk e dimë.

- Ninac Vukodaliq, i cili ishte kancelar i Skënderbeut dhe nga emri duket që është dubrovnikas. Emri i tij del në një dokument të muajit qershor (13 qershor) të vitit 1459,<sup>140</sup> e më vonë edhe në dokumente të muajit tetor të vitit 1463.
- Paladino de Gondola, ambasador i Skënderbeut, emri i të cilit del në disa dokumente të muajit tetor të vitit 1463.<sup>141</sup> I përkiste familjes Gondola me origjinë arbërore, të ardhur mbase nga Lezha diku në Mesjetën e Mesme.<sup>142</sup>

\* \* \*

Këto pra, ishin disa nga stacionet kryesore të marrëdhënieve ndërmjet Kastriotëve dhe Republikës së Raguzës. Paraqitja sa më e plotë

<sup>138</sup> Shih të dhënat nga Enciklopedia kroate Proleksis: “Gjin Gazulli, (Ivan, Joannes Gazulić), hrvatski astronom i diplomat albanskoga podrijetla (? , oko 1400 – Dubrovnik, 19. II. 1465). Dominikanac, doktorirao u Padovi (1430). Ugarsko-hrvatski kralj Matija Korvin poziva ga 1459. za dvorskog astrologa, ali poziv nije prihvatilo. U djelu *De directionibus...* (O smjerovima...) iznio svoju metodu podjele neba na nebeske kuće (Gazulli–Campanova metoda). Ta je metoda bila poznata u Krakovu i Parizu i utjecala je na jednostavniji Regiomontanusov postupak određivanja nebeskih kuća”, në: Proleksis Enciklopedija. URL: <https://proleksis.lzmk.hr/22885/> (8.22. 2020)

<sup>139</sup> G. Valentini, *Vepra III ...*, f. 73.

<sup>140</sup> DAD, *Diplomata et Acta*, 15 st., nr. 287, në Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CXLVI. Tek vepra e Ljubomir Stojanoviqit, L. Stojanović, *Stare srpske povelje ...*, dok. nr. 797, f. 215, emri i Ninacit, jepet si *Ninec*, kurse në dokumentin 795 emri jepet i plotë bashkë me mbiemër.

<sup>141</sup> DAD, *Acta Cons. Rog.* Vol. XVII (1461-1464), në: Gj. Berisha, *Gjergj Kastrioti-Skënderbeu ...*, dok. nr. CLXXXVIII.

<sup>142</sup> Rreth kësaj familjeje shih më gjerë tek: E. Malaj, “Në gjurmë të familjeve fisnike raguzane ...”, f. 13-14; “Bujarë arbërorë në Raguzë”, në Jahja Drançolli, *Arbërit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë Mesjetës*, Zagreb: Misioni Katolik Shqiptar, Kroaci: 2008, f. 365.

dhe e detajuar e kësaj teme, sigurisht që nuk është detyrë e një artikulli të vetëm. Shpresojmë që ta zgjerojmë atë në një punim më të plotë, por për momentin po mjaftohemi me këto faqe, të cilat japin një skicim të përgjithshëm të këtyre marrëdhënieve.

## **Përmbledhje**

Në këtë artikull fokusi i hulumtimit janë marrëdhëniet e Kastriotëve me Republikën e Raguzës. Kryesisht u përqendruam në periudhën e Skënderbeut, sepse pikërisht gjatë kësaj kohe ka një intensitet më të madh të marrëdhënieve, dhe nga ana tjetër ato janë të dokumentuara më mirë, megjithëse marrëdhëniet e Kastriotëve me Raguzën fillojnë që në kohën e Gjon Kastriotit. Për marrëdhënie të tjera më të hershme nuk kemi asnjë të dhënë. Ky hulumtim është i ndarë në disa pjesë. Më të hulumtuara janë çështjet diplomatike dhe ekonomike-tregtare. Ky studim është i mbështetur kryesisht në dokumente arkivore, por përveç tyre janë pasur parasysh edhe studime të ndryshme.

## *S u m m a r y*

### THE KASTRIOTI FAMILY AND RAGUSA

In this paper the focus of the research are the relations of Kastrioti family with the Republic of Ragusa. Mainly, we were focused on Scanderbeg's period, because during this time there is a greater intensity of relations, and from the other part they are better recorded, nonetheless the relations of Kastrioti family with Ragusa begin since the time of Gjon Kastrioti. On other earlier relations, we do not have any data. This research is divided in some parts, also more detailed are the diplomatic and economic-trade questions. This research is mainly based on archival documents, but except them, are also taken into consideration different studies.

